

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Nënskruar me datë 13/09/2021

Ndërmjet

- Z. Aldenis Çullhaj, lindur me dtl 21/09/1981, ne Elbasan dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr I15921162M (në vijim “**Shitësi**”), ose “Pala” ose bashkarisht “Palët”;

dhe

- Znj. Jordisa Metaj, lindur me dtl 22.05.1989, ne Berat dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr I95522080B (në vijim “**Blerësi**”), ose “Pala” ose bashkarisht “Palët”;

të gjitha palët zotërojnë aftësi të plotë për të vepruar, me vullnet të lirë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë kontratë për shitjen e kuotave sipas kushteve të mëposhtme.

Duke pasur parasysh se

- Palët zotërojnë secili nga 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë “LEGUS CONSULTING” Sh.p.k., e regjistruar në Regjistrin Tregtar (QKR) me numër unik identifikimi (NUIS) L82426011T (në vijim “**Shoqëria**”);
- Znj. Jordisa Metaj shpreh interesin e saj për blerjen e 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “LEGUS CONSULTING” sh.p.k në zotërim të Z. Aldenis Çullhaj.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, palët bien dakortë për sa më poshtë vijon:

NENI 1

Kushtet paraprake të sipërpërmendura janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

NENI 2

Shitësi i shtet me të drejta pronësie të plota Blerësit, i cili siç është përcaktuar më sipër pranon dhe blen 50% të kapitalit themeltar, me çmimin e barabartë me 50,000 (pesëdhjet mijë) LEK, shumë që pala blerëse deklaron se i ka paguar palës shitëse e cila pranon se i ka marrë nga pala blerëse më parë.

NENI 3

Z. Aldenis Çullhaj deklaron se këto kuota janë në pronësi të tij të plotë dhe ekskluzive, nuk janë objekt çështje gjyqësore në zhvillim e sipër dhe gjithashtu janë të lira nga çfarëdolloj pengu apo barre.

NENI 4

Me anë të kësaj kontrate Shitësi humbet të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me pjesët e shitura dhe çfarëdo të drejte apo detyrimi të shoqërisë të fituara deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ndërsa Blerësi bëhet pronar i pjesëve të blera duke fituar njëkohësisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura e kuotave dhe shoqërisë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë.

NENI 5

Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme që janë të lidhura me këtë objekt. Ndryshime të mundëshme ose kufizime kësaj kontrate mund t'i bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe t'i bashkëngjiten asaj.

NENI 6

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe në 2 (dy) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, të gjitha të nëshkruara nga palët dhe rregullohet nga Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

SHITËSI

Z. Aldenis Çullhaj



BLERËSI

Znj. Jordisa Metaj

